

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-078/13

**Prishtinë,
12 shkurt 2014**

Në çështjen juridike të:

M. G.

Kralevē, Serbi

Paraqitësja e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kundër

R.S

Kosovë

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva- Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/100/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA47967) të datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 12 shkurt 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

1. **Pranohet si e bazuar ankesa e R. S.**
2. **Anulohet vendimi KPCC/D/A/100/2011 i datës 23 shkurt 2011 për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 47967 dhe lënda kthehet në KKPK për rishqyrtim.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datën 18 tetor 2007, M. G. kishte paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte ri-posedim të pronës bujqësore të regjistruar si parcela nr.1492 në sipërfaqe prej 0.31.60 në vendin e quajtur “Crkolez”, Zona Kadastrale Çwrkolez, Komuna e Istogut dhe kërkonte kompensim për periudhën gjatë së cilës asaj iu kishte ndaluar posedimi i kësaj prone. Së bashku me kërkesën ajo kishte dorëzuar kopjen e fletës poseduese nr.29, e leshuar me datw 13 gusht 1986 nga ana e Drejtoris se Gjedoewizw e Komunws sw Istogut, ku pronar i regjistruar paraqitej Janićije Gajic. Ajo gjithashtu kishte dorëzuar certifikatën e vdekjes të personit të lartpërmendur si dhe kopjen e certifikatës së martesës. Të gjitha këto dokumente janë verifikuar pozitivisht nga AKP.
2. Në kërkesë është theksuar se prona është uzurpuar nga një person i panjohur. Uzurpuesi i pretenduar nuk është njoftuar në mënyrë të drejtpërdrejte për kërkesën.
3. Me datën 28 janar 2009, AKP ka bërë njoftimin për kërkesën përmes një shenje të vendosur në pronën e gabuar. Ishte konstatuar se nuk ishte e zënë gjatë vizitës sw bwrw nga ekipi njoftues.
4. Ishte vërtetuar se njoftimi për kërkesën nuk ishte bërë në mënyrën e saktw. Me Vendimin e KKPK-së të datës 24 maj 2010, nr. KPCC/RES/20/2010, vendimi i mëhershëm i KKPK-së ishte anuluar dhe kërkesa ishte kthyer në Sekretarinë Ekzekutive për procedim të mëtejme për identifikimin e saktë tw kwrkesws dhe njoftimit të duhur të pronës së kërkuar dhe dëgjimin e cilësdo palë përgjegjëse në lidhje me kërkesën.
5. Njoftimi me publikim në Gazetën e AKP-së dhe Buletinin e Zyrës së Pronës të UNMIK-ut është bërë me datën 24 shtator 2010. Me rastin e njoftimit lidhur me pronwn qw wshtw objekt i kwrkesws nuk ishte bwrw asnjw identifikim i pronws qw wshtw objekt i kwrkesws. Nuk është dorëzuar asnjë njoftim për pjesëmarrje.
6. Me datën 23 shkurt 2011, KKPK ka miratuar kërkesën lidhur me pronën dhe posedimin duke urdhëruar qw çdo person që e ka uzurpuar pronën ta liroj atë brenda 30 ditëve.

7. Vendimi i KKKPK i është dërguar R. S. –si uzurpuesi aktual – me datën 25 mars 2013. Me datën 28 mars 2013 ai ka paraqitur një ankesë kundër vendimit.
8. Ankesa i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës me datën 25 korrik 2013. Ajo kishte dorëzuar përgjigje me datën 26 gusht 2013.

Argumentet e palëve

9. Paraqitësja e kërkesës mbështetet në fletën poseduese nr. 29 të regjistruar në emër të J. G. dhe kërkon që t'i kthehet e drejta e pronës. Pala ankuese nuk e kundërshton këtë regjistrim; megjithatë, pretendon se babai i tij e ka blerë atë nga S. (R.) B. në vitin 1992 i cili paraprakisht e ka blerë atë nga J. G. në vitin 1988. Ai pretendon se ka qenë duke e shfrytëzuar këtë tokë pa ndonjë pengesë që nga ajo kohë. Ai gjithashtu ka pretenduar të ketë dëshmitarë në lidhje me këtë shitje dhe ka dorëzuar një kopje të dokumentit për pagesën e parave për blerjen e pronës së kërkuar se M. G. (paraqitësja e kërkesës), gruaja e J. G. ka qenë e pranishme gjatë dorëzimit të parave. Ai ka dorëzuar një faturë nr.10468 të datës 27 mars 2013 që i referohet emrit të tij. Ai ka pretenduar se toka nuk ka mundur të regjistrohet në emër të blerësve për shkak të ligjeve diskriminuese të asaj kohe që ndalonin shitjet në mes të serbëve dhe shqiptarëve.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Pala ankuese nuk ishte palë në procedurën para KKKPK-së. Sipas nenit 12.1, vendimi i KKKPK-së mund të apelohej nga “pala” pranë KKKPK-së. Megjithatë, Gjykata Supreme ka vendosur në disa kwrkesa “inter alia”, në mes tjerash edhe në lëndën nr. GKS-KPA-A-109-2012 se kjo rrethanë nuk mund të shkojë në dëm të palës ankuese me interes ligjor e cila nuk është njoftuar në mënyrën e duhur për kërkesën.
11. Në rastin konkret poseduesi/uzurpuesi i pronës nuk është përmendur në kërkesë dhe as njoftuar për kërkesën. Një shenjë ishte vendosur në pronën e cila doli të jetë pronë e gabueshme. Një njoftim ishte bërë në Gazetën Notifikuese të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-it. AKP nuk ka bërë “përpyetje të arsyeshme” për të njoftuar për kërkesën siç kërkohet me nenin 10.1. Prandaj, pala ankuese, e cila ka interes ligjor në lëndën në fjalë, nuk ka qenë në dijeni për kërkesën dhe nuk ka pasur mundësi të përgjigjet në kërkesë.

12. R. S. ka apeluar vendimin e KKPK-së brenda 30 ditëve pasi që është vënë në dijeni për lëndën dhe vendimin e KKPK-së. Gjykata Supreme e shpall ankesën të pranueshme.

Meritat e ankesës

13. Objekti i shqyrtimit dhe vlerësimit të KKPK-së nuk ishte kontrata e blerjes së pronës që është objekt i kërkesës së anulimit të vendimit të 1992. Prandaj Sekretaria Ekzekutive nuk e ka shqyrtuar, verifikuar dhe vlerësuar kështu provat juridikisht të vlefshme. Përpos kësaj KKPK-ja për rrjedhojë nuk kishte ekzaminuar sikundër provat e propozuara nga pala ankuese ashtu edhe pala përgjegjëse në ankesë.
14. Gjykata Supreme në disa raste, aty ku kërkesa ishte konsideruar si e pa-kontestuar dhe pala ankuese nuk ka qenë në dijeni për kërkesën, e pa të domosdoshme të anuloi vendimin e KKPK dhe të kthej lëndën për rishqyrtim. Gjykata i referohet lëndës nr. GSK-KPA-A-14-2012. Kjo procedurë e lejon palën ankuese të marrë pjesë në procedurë para shkallës së parë dhe e lejon palën përgjegjëse në ankesë të paraqet ankesë ndaj vendimit që ka qenë objekt i rishqyrtimit të të gjitha fakteve relevante të kësaj çështje juridike.
15. Në lëndën aktuale Gjykata Supreme e konsideron këtë procedurë të domosdoshme në mënyrë që të sigurohet një gjykim i drejtë dhe i rregullt. Vendimi i KKPK-së anulohet dhe kthehet në rishqyrtim. AKP-ja mbetet të verifikoj dokumentet e dorëzuar nga pala ankuese. Ky hulumtim gjithashtu mund të ndikoj gjatë vendosjes së ndërlidhet humbja e pronës me rrethanat e konfliktit të armatosur apo me shitjen e mëparshme; pra, edhe kompetenca e KKPK-së në lidhje me lëndën në fjalë mund të vihet në pikëpyetje. Gjatë rishqyrtimit të lëndës KKPK-ja duhet të vendosë nëse:
- KKPK ka kompetencë në lidhje me lëndën në fjalë, në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe;
 - Nëse po, të vlerësojë meritat e lëndës, duke marrë parasysh provat e palës ankuese.

Udhëzim juridik

16. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX- it